

UDHËZIM
Nr. 11, datë 8.5.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 24.9.2021, “PËR KËRKESAT SPECIFIKE TË HIGJENËS PËR MISHIN DHE PRODUKTET E MISHIT, DUKE PËRFSHIRË PRODUKTET E MISHIT, MISHIN E GRIRË DHE MISHIN E NDARË NË MËNYRË MEKANIKE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, dhe të neneve 131 dhe 132, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 24.9.2021, “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Shtojca VIII zëvendësohet me shtojcën VIII/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe bëhet pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË
DHE MBROJTJES SË BIMËVE

1. Plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor të thertores.
2. Plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor të thertores.

1. Plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor të thertores.

2. Plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor të thertores.

